



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi a) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Smart Eng Group" Sh.P.K. të datës 05.05.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 02.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi dhe mirëmbajtja e dysHEMEVE për IEA" me nr. të prokurimit 616-23-1780-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Smart Eng Group" Sh.P.K. e datës 05.05.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 02.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi dhe mirëmbajtja e dysHEMEVE për IEA" me nr. të prokurimit 616-23-1780-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi. Autoriteti Kontraktues, për nënshkrim të kontratës, duhet të pres se paku 10 ditë kalendarike me efekt nga dita pas datës në të cilën autoriteti kontraktues ka marrë këtë vendim.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Smart Eng Group" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Smart Eng Group" Sh.P.K. (tutje "parashtuesi") me datë 05.05.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 02.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi dhe mirëmbajtja e dysHEMEVE për IEA" me nr. prokurimi 616-23-1780-5-2-1.

Faqe 1 nga 3

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimi i parashtruesit është cituar si në vijim:** *“Autoriteti kontraktues me qëllim e ka ngarkuar paramasen me gabime aritmetike, që te favorizohen kompanitë, dhe kompanit tjera te elimonohen si ne këtë aktivitet te prokurimit”*.

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”).

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 15.05.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Për shqyrtimin e pretendimit të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale:

- B05 Njoftimi për kontratë i dt. 07.03.2023.
- Dosja e tenderit e dt. 07.03.2023.
- Oferta e parashtruesit.
- B12 Procesverbali i hapjes së tenderëve i dt. 29.03.2023.
- Raporti i vlerësimit të tenderëve i dt. 27.04.2023.
- B58 Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 02.05.2023.
- Letra standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 02.05.2023.

Me rastin e shqyrtimit të pretendimit ankimor fillimisht është gjetur se parashtruesi nuk ka treguar se për cilat “gabime aritmetike” në paramasë bëhet fjalë. Aq më tepër nuk ka specifikuar se mbi cilat argumente e bazon konstatimin se këto gabime aritmetike qenkan bërë me qëllim nga autoriteti kontraktues. Së këndejmi nga formulimi i pretendimit ankimor nga parashtruesi si në vijim *“Autoriteti kontraktues me qëllim e ka ngarkuar paramasen me gabime aritmetike”*, është e pamundur që të kuptohet se me cilat dispozita juridike janë shkelur me cilat veprime konkrete nga autoriteti kontraktues. Sa i përket pjesës tjetër të pretendimit ku thuhet se *“që te favorizohen kompanitë, dhe kompanit tjera te elimonohen si ne këtë aktivitet te prokurimit”* duhet shtuar që parashtruesi ka pasur mundësi që të kundërshtoj dosjen e tenderit apo të kërkoj sqarime shtesë nëse ka pretenduar se ekzistojnë kritere favorizuese apo diskriminuese. Mirëpo parashtruesi asnjëherë nuk e ka ndërmarrë një veprim të tillë. Sidoqoftë edhe përmes pretendimit ankimor në këtë kërkesë për rishqyrtim, parashtruesi nuk ka arritur se cili kriter përkatësisht cili gabim aritmetik apo gabim tjetër është bërë nga autoriteti kontraktues dhe me këtë rast mbi cilat argumente e bazon parashtruesi pretendimin se është shkelur LPP. Rrjedhimisht nga shqyrtimi i pretendimit të parashtruesi dhe nga administrimi i provave materiale në këtë rast nuk janë evidentuar shkeljet ligjore që pretendohen nga parashtruesi. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parë i parashtruesit është i pabazuar.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin a) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 15.05.2023**

**Visar SHEHU**  
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.